

VENDIM
Nr.428, datë 9.6.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I VARREZAVE
PUBLIKE NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë arë), që preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shijakut.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompesohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 950 (katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) m² tokë arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 4 950 000 (katër milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekësh dhe të përballohet nga bashkia e Shijakut.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit korrik 2005.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Shijakut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE
TË QYTETIT TË SHIJAKUT**

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë m/2	Njësia lekë m/2	Vlera lekë
1.	Asllan Ibrahim Keçi	4950	1000	4 950 000
	Totali			4 950 000